



Departamenti i Prokurimit

Prishtinë: datë 16.06.2020

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 15.06.2020 të parashtruar nga Operatori Ekonomik "Lulzim Katanolli B.I" për aktivitetin: "**Deratizimi,dezinfektimi dhe dezinfektimi ne objektet shendetesore**" dhe me numër të prokurimit: 616-20-017-221 nxjerr:

VENDIM

1. **Refuzohet** kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik "Lulzim Katanolli B.I" e datës 15.06.2020 lidhur me aktivitetin e prokurimit: "**Deratizimi,dezinfektimi dhe dezinfektimi ne objektet shendetesore**" me Nr. 616-20-1192-2-2-1, me Nr. Brendshëm : 616-20-017-221.
2. Autoriteti Kontraktues, vendos që *te mbetet ne fuqi Vendimi per anulim te aktivitetit i dates 08.06.2020.*
3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

Arsyetim

Operatori Ekonomik "Lulzim Katanolli B.I" me datë 15.06.2020 ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "**Deratizimi,dezinfektimi dhe dezinfektimi ne objektet shendetesore**" me numër të prokurimit me Nr. 616-20-1192-2-2-1, dhe numër të brendshëm 616-20-017-221.

Autoriteti Kontraktues, me datë 16.06.2020, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë dhe ka konstatuar si vijon:

-Pretendimi juaj se Autoriteti Kontraktues nuk ka respektuar nenin 1 të LPP-se, respektivisht se nuk ka siguruar menyren efikase dhe transparente të shfrytëzimit të fondeve është plotësisht i pa qendrueshëm për faktin se edhe sikur të ishte tenderi juaj i përgjegjshëm në aspektet tjera

ne kete aspekt çmimi i dhene ne tenderin tuaj do te ishte ne kundërshtim me qëllimin e ketij neni;

-Pretendimi per shkelje te nenit 54 te LPP-se poashtu eshte i pa bazuar per faktin se ju keni paraqitur per kryerjen e shërbimeve nje preparat qe nuk ka perberjen e kerkuar ne dosjen e tenderit, respektivisht perberjen e kerkuar ne Aneksin 1 te Dosjes se tenderit;

-Pretendimi se vleresimi i tenderit tuaj nuk eshte bere ne harmoni me nenin 59 poashtu eshte i pa qendrueshem pasi qe vleresimi eshte kryer ne harmoni te plote me dispozitat ligjore dhe kerkesat e dosjes se tenderit;

-Pretendimi se ju keni ofruar materiale me te preferueshme per kryerjen e shërbimeve te parapara mund te jete i bazuar, por ua perseris se perberja e tyre eshte ne kundërshtim me kerkesen tone dhe ju si OE-ik serioz eshte dashte te shfrytezoni afatet per sqarime dhe plotesime para hapjes se tenderit per te na bindur ta ndryshojme kerkesen tone lidhur me perberjen e preparatit te kerkuar ne dosjen e tenderit.

Bazuar ne sqarimet nga arsyetimi u vendos si ne Dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa pranë OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjetë) diteve pas pranimit te ketij vendimi.


Zyrtari përgjegjës i Prokurimit